

STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“CLINK DEV” SH.P.K.

Datë 30 Prill 2025

KREU I. TË PËRGJITHSHME

Neni 1.01. Përkufizime

Fjalët me shkronja të mëdha të përdorura në këtë Statut do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

“Administrator” nënkupton personin përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të veprimtarisë së Shoqërisë, në përputhje me kufizimet e parashikuara në këtë Statut.

“Asamble” nënkupton mbledhjen e anëtarëve të Shoqërisë, e cila përfshin të gjithë Anëtarët.

“Ditë Pune” nënkupton çdo ditë tjetër përveç të shtunës, së dielës ose çdo dite tjetër në të cilën bankat tregtare në Shqipëri janë të autorizuar ose të detyruara të jenë të mbyllura.

“Barrë” nënkupton çdo hipotekë, peng, interes sigurie, barrë, kufizim përdorimi ose transferimi, përveç atyre të vendosura me ligj, marrëveshje votimi, pretendim të pafavorshëm ose pagesë të çdo lloji (përfshirë çdo marrëveshje për të dhënë ndonjë nga sa më sipër), çdo shitje me kusht ose marrëveshje tjetër për të mbajtur titullin e pronësisë ose të përdorimit, ose çdo qira me natyrë të tillë.

“Filial” i një Personi do të thotë çdo Person tjetër që, drejtpërdrejt ose tërthorazi, Kontrollon, është nën Kontroll të përbashkët me, ose Kontrollohet nga ky Person.

“Kontroll” i një Personi nga një Person tjetër do të thotë se Personi i dytë zotëron drejtpërdrejt ose tërthorazi fuqinë për të drejtuar ose shkaktuar drejtimin e menaxhimit dhe politikave të Personit të parë, me anë të zotërimit të titujve të kapitalit, me anë të kontratës ose me çdo mjet tjetër dhe termat “i kontrolluar nga” dhe “nën kontroll të përbashkët me” kanë kuptimet përkatëse.

“Kryetar” ka kuptimin e dhënë në Nenin 3.02, shkronja (c).

“Ligji i Zbatueshëm” nënkupton çdo ligj (përfshirë Ligjin për Shoqëritë Tregtare), akt nënligjor, akt normativ kombëtar ose vendor, urdhër, dekret ose akt tjetër, kod, direktivë, vendime dhe akte të ministrave, qarkore të departamenteve, rregullore, deklarata dhe interpretime të organeve zyrtare të Republikës së Shqipërisë, çdo vendim gjykate ose çdo licencë, miratim, leje ose autorizim ose miratime të tjera në fuqi, të Republikës së Shqipërisë, ose të çdo njësie administrative ose ndarjeje ose të çdo personi të krijuar me ligj (pavarësisht nëse është i pavarur ose jo), që ka juridiksionin përkatës, përfshirë ndryshimet e tyre të herëpashershme.

“Ligji për Shoqëritë Tregtare” nënkupton Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.

“Ngjarje Shkaktuese” nënkupton secilën nga ngjarjet e mëposhtme:

(i) Shpërbërja dhe likuidimi i një Anëtarit;

(ii) Një vendim gjyqësor për shpalljen e falimentimit të Anëtarit;

“Anëtar” ka kuptimin e dhënë në Nenin 1.04 (Anëtarët e Shoqërisë).

“Statut” nënkupton këtë statut të Shoqërisë.

“Shoqëri” ka kuptimin e dhënë në Nenin 1.03, shkronja (c).

“Person” nënkupton çdo person fizik, pronësi individuale, ortakëri, firmë, kompani, korporatë, shoqatë, fondacion, trust, organizatë e pa



inkorporuar, sipërmarrje të përbashkët ose person apo subjekt tjetër juridik, përfshirë çdo Autoritet Qeveritar.

Neni 1.02 Interpretimi

(a) Çdo e drejtë, detyrim ose kusht i përshkruar në këtë Statut do të interpretohet në kontekstin e Statutit në tërësi, duke marrë parasysh objektivat që i shtynë Palët të lidhin këtë Statut. Titujt e kapitujve, neneve, paragrafëve dhe nënparagrafëve që përmban ky Statut, si dhe ato të renditura në tabelën e përmbajtjes, janë vetëm për qëllime referimi dhe nuk do të ndikojnë në asnjë mënyrë kuptimin ose interpretimin e këtij Statuti. Të gjitha anekset dhe shtojcat e bashkangjitura ose të referuara në këtë dokument janë përfshirë dhe përbëjnë një pjesë integrale të këtij Statuti. Nëse një term i përdorur në ndonjë aneks ose shtojcë është me shkronjë të madhe, por nuk është i përcaktuar aty, do të ketë kuptimin që i jepet në këtë Statut. Referencat brenda tekstit të këtij Statuti për një kapitull, nen, paragraf, nënparagraf, aneks ose shtojcë do t'i referohen përkatësisht kapitullit, nenit, paragrafit, nënparagrafit, aneksit ose shtojcës përkatëse të këtij Statuti, përveç rasteve kur shprehimisht parashikohet ndryshe.

(b) Me përjashtim të rasteve kur shprehimisht parashikohet ndryshe, në këtë Statut:

- (1) Fjalët e përdorura në njëjës do të përfshijnë edhe shumësin dhe anasjelltas;
- (2) Fjalët e përdorura në një gjini ose rasë, sipas rastit, edhe gjinitë ose rasat e tjera;
- (3) Nëse një term është i përcaktuar, format e tjera gramatikore të tij do të kenë kuptimin përkatës; dhe
- (4) Termi "përfshin" do të thotë "përfshin, pa kufizim".

Neni 1.03 Organizimi dhe Emri i Shoqërisë

(a) Themelimi. Anëtarët miratojnë themelimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, për qëllimet dhe brenda fushës së zbatimit të përcaktuar me këtë Statut. Anëtarët ose Administratori i autorizuar prej tyre, do të depozitojnë menjëherë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dokumentet e nevojshme në lidhje me themelimin dhe funksionimin e Shoqërisë, sipas kërkesave ose në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm.

(b) Emri. Emri i Shoqërisë është Clink Dev sh.p.k.

(c) Organizimi. Clink Dev sh.p.k. themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare ("**Shoqëria**").

(d) Aktiviteti. Shoqëria e ushtron veprimtarinë e saj, sipas objektit të përcaktuar në këtë Statut, në bazë të Ligjit të Zbatueshëm dhe Statutit.

Neni 1.04 Anëtarët e Shoqërisë



- (a) Shoqëria është themeluar nga anëtarët e mëposhtëm:
- (1) **Clink S.r.l.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve italiane, e e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive të Vicenza me numër 04337050241, REA VI-396758 dhe me adresë të regjistruar në Largo Parolini 6, Bassano del Grappa, Vicenza, Itali, e përfaqësuar nga përfaqësuesi i saj i autorizuar Stefano Falcone, i identifikuar me nr pashaporte YC0598758, lindur në Eboli (ITA) dhe banues në Bassano del Grappa, viale Venezia, 39, Itali ("**Anëtari 1**"); dhe
 - (2) **Vincenzo Scolavino**, i identifikuar me pashaportë nr YB4727234, lindur në San Paolo Bel Sito dhe banues në Rr. Ullishtes, Nd. 6. H.1, Farkë, Tirana, ("**Anëtari 2**");
 - (3) **Evelina Merkaj**, e identifikuar me kartë identiteti me nr identifikimi J65708095F, lindur në Elbasan dhe banuese në Rr Shpëtim Arapi Nd. 34 H3 Ap 7, Elbasan 3001, ("**Anëtari 3**");

(në tekstin e mëtejshëm, individualisht do të referohen gjithashtu si "**Anëtari**" dhe së bashku si "**Anëtarët**").

(b) Përveç rasteve kur vendoset ndryshe nga Asambleja, Anëtarët nuk do të jenë të detyruar nga ndonjë detyrim për ndalim konkurrence ndaj Shoqërisë, përfshirë kufizimet për konkurrencë të përcaktuara në Nenin 17, paragrafi 1, të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 1.05 Kohëzgjatja

(a) Data e Regjistrimit. Data e regjistrimit të Shoqërisë do të jetë data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

(b) Kohëzgjatja. Kohëzgjatja e Shoqërisë është vendosur deri më 31 (tridhjetë e një) Dhjetor 2080 (dy mijë e tetëdhjetë) ose, nëse ndodh më herët, deri në shpërbërjen e Shoqërisë në përputhje me dispozitat e këtij Statuti, vendimet e marra në bazë të tij, ose kur kjo parashikohet nga Ligji i Zbatueshëm. Në çdo rast, kohëzgjatja e Shoqërisë mund të zgjatet me vendim të Asamblesë.

Neni 1.06. Vula

Shoqëria do të ketë vulën e saj, e cila do të mbajë emrin tregtar të saj.

Neni 1.07 Selia

(a) Selia. Selia e Shoqërisë është Rr Sulejman Delvina Nd. 2 H 23 Kati 8 Ap. 24.



(b) Degët. Asambleja mund të vendosë të hapë degë, zyra përfaqësimi, themelojë filiale ose të marrë pjesë në shoqëri të tjera me anëtarë të tjerë, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

Neni 1.08 Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë si më poshtë:

- (a) zhvillimi, prodhimi dhe tregtimi i softuerëve dhe zgjidhjeve dixhitale, duke përfshirë projektet e integritit ndërmjet sistemeve ekzistuese;
- (b) krijimi, regjistrimi, dhënia në përdorim dhe menaxhimi i licencave të përdoruesve, si dhe krijimi i kodeve burimore dhe platformave të IT-së;
- (c) projektimi, zhvillimi dhe menaxhimi i platformave të tregtisë elektronike (e-commerce) dhe faqeve të internetit;
- (d) integrimi dhe personalizimi i zgjidhjeve CRM, në formë të përgjithshme ose në platforma të specializuara;
- (e) ofrimi i shërbimeve të asistencës teknike, mirëmbajtjes dhe përditësimit të sistemeve informatike dhe dixhitale;
- (f) projektimi, zhvillimi dhe zbatimi i teknologjive të inteligjencës artificiale (AI) dhe të të mësuarit të makinerive (machine learning), duke përfshirë krijimin e produkteve dhe zgjidhjeve të bazuara në AI;
- (g) konsulenca strategjike, organizative dhe teknologjike që synon transformimin dixhital të shoqërive dhe kalimin e tyre në përdorimin e sistemeve të AI, si dhe implementimin, menaxhimin dhe migrimin drejt platformave dhe shërbimeve në cloud;
- (h) studimi, zhvillimi dhe implementimi i projekteve të kalimit në cloud dhe integrimi i tyre me infrastrukturën ekzistuese të IT-së;
- (i) ofrimi i kurseve të trajnimit dhe zhvillimit profesional në fushat e sipërpërmendura;
- (j) ofrimi i shërbimeve të vendosjes në dispozicion të burimeve njerëzore ose personelit të specializuar ("body rental") për mbështetjen e projekteve në fushën e IT-së dhe zgjidhjeve digjitale.

Shoqëria gjithashtu mund të kryejë të gjitha operacionet tregtare, industriale, të letrave me vlerë, të pasurive të paluajtshme dhe financiare që janë instrumentale ose të lidhura me arritjen e qëllimit të saj shoqëror, si dhe të blejë pjesëmarrje në shoqëri ose sipërmarrje të tjera me qëllime të ngjashme të lidhura ose të ndërlidhura, si dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të lejuar nga Ligji i Zbatueshëm.

KREU II. KAPITALI DHE KUOTAT

Neni 2.01 Kapitali i regjistruar

(a) Kapitali i regjistruar. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 100.000,00 lekë dhe ndahet në 3 (tre) kuota (individualisht "**Kuota**" dhe bashkërisht "**Kuotat**").

(b) Zotërimi i Kuotave. Anëtarët do të zotërojnë Kuotat si më poshtë:

- (1) Clink srl, zotërues i 1 (një) Kuote dhe kontribues i 60,000 lekë, që përbën 60% të kapitalit; dhe
- (2) Vincenzo Scolavino, zotërues i 1 (një) Kuote dhe kontribues i 20,000 ALL lekë, që përbën 20% të kapitalit.
- (3) Evelina Merkaj, zotërues i 1 (një) Kuote dhe kontribues i 20,000 ALL lekë, që përbën 20% të kapitalit.

(c) Nuk Ofrohen për Publikun. Kuotat e Shoqërisë nuk do të ofrohen për publikun.

(d) E drejta e Votës. Çdo Kuotë përfaqëson të drejtën e votës në përpjesëtim me pjesëmarrjen përkatëse në kapitalin e Shoqërisë.

(e) Pagesa e Kapitalit. Anëtarët do të paguajnë plotësisht kapitalin e regjistruar brenda 2 (dy) muajve nga regjistrimi i Shoqërisë.

Neni 2.02 Regjistri i Kuotave

(a) Regjistri i Kuotave. Kuotat dhe zotëruesit e tyre përkatës, si dhe të dhëna të tjera lidhur me Kuotat e kapitalit të regjistruar, regjistrohen në një regjistër të veçantë që mbahet nga Shoqëria.

(b) Forma dhe Përmbajtja. Forma dhe modalitetet e tjera të regjistrimit miratohen me vendim të Asamblesë.

Neni 2.03 Transferimi i Kuotave të Kapitalit të Regjistruar

(a) Transferimi i Kuotave. Transferimet e Kuotave të realizuara gjatë jetës ("inter vivos") i nënshtrohen të Drejtës së Parablerjes të përshkruar në paragrafin (c), të Drejtës së Bashkë-Shitjes ("Tag-Along") të parashikuar në paragrafin (g) dhe të Drejtës së Detyrimit për Bashkë-Shitje ("Drag-Along") të përshkruar në paragrafin (h) më poshtë.

(b) Për qëllimet e këtij statuti, "transferim" nënkupton çdo transferim, kundrejt pagesës ose pa pagesë, i cili ka si rezultat, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ndryshimin e pronësisë së kuotave ose të të drejtave opsionale, duke përfshirë, por pa u kufizuar në shitjen dhe blerjen, dhurimin, shkëmbimin, kontributin në Shoqëri, ose organizata me ose pa personalitet juridik ose Trust-e, krijimin e të ardhurave, pagesën në natyrë, transferimin "e detyruar" ose "të shtyrë", transferimin e mandatit të besimit, transferimin në kuadër të shitjes ose dhënies së një shoqërie, bashkimit ose ndarjes.

(c) E drejta e Parablerjes. Për ushtrimin e së drejtës së parablerjes ("**E drejta e Parablerjes**"), do të zbatohet dispozita e mëposhtme e përcaktuar në këtë paragraf (c). Në rast se një Anëtar (për qëllimet e këtij paragrafi (c), "**Anëtari Shitës**") merr nga një palë e tretë (për qëllimet e këtij paragrafi (c)



"**Palë e Tretë Blerëse**"), një ofertë për blerjen e të gjitha ose një pjese të Kuotave të Anëtarit Shitës (për qëllimet e këtij Neni "**Kuotat e Ofruara**"), dhe Anëtari Shitës është i gatshëm t'i transferojë Kuotat e Ofruara te Pala e Tretë Blerëse, Anëtari Shitës duhet t'u japë Anëtarëve të tjerë të Shoqërisë (për qëllimet e këtij Neni "**Anëtarët e Ofruar**"), si dhe Administratorit/ëve, një njoftim me shkrim (për qëllimet e këtij paragrafi (c) "**Njoftimi i Shitjes**") të dërguar me letër të regjistruar me konfirmim marrje (ose me çdo mënyrë tjetër të ngjashme që siguron provë pranimit), duke i informuar për synimin e tij për t'i shitur Kuotat e Ofruara Palës së Tretë Blerëse. Njoftimi i Shitjes duhet të specifikojë emrin e Palës së Tretë Blerëse, çmimin e propozuar të shitjes së Kuotave të Ofruara (duke përfshirë një përshkrim të çdo kundërvlere jomonetare në detaje të mjaftueshme për vlerësimin e saj), si dhe çdo term, kusht dhe detaj tjetër të kësaj shitjeje (përfshirë deklaratat dhe garancitë). Njoftimi i Shitjes do të konsiderohet si një "ftesë për të bërë një ofertë" të Anëtarit Shitës ndaj Anëtarëve të Ofruar. Në çdo kohë brenda 30 (tridhjetë) Ditëve Pune nga marrja e Njoftimit të Shitjes (për qëllimet e këtij paragrafi (c) "**Afati i Parablerjes**"), nën kërcënimin e humbjes së të drejtës, Anëtarët e Ofruar mund të informojnë me shkrim Anëtarin Shitës për qëllimin e tyre për të pranuar ofertën siç specifikohet në Njoftimin e Shitjes, për të gjitha, por jo më pak se të gjitha Kuotat e Ofruara (për qëllimet e këtij paragrafi (c) "**Njoftimi i Pranimit**"). Një pranim i pjesshëm ose i jo i plotë, ose një Njoftim Pranimi që ndryshon ofertën e përcaktuar në Njoftimin e Shitjes do të konsiderohet si mospranim. Nëse më shumë se një Anëtar i Ofruar ushtron të Drejtën e Parablerjes, kjo e drejtë do të konsiderohet e ushtruar nga secili prej tyre në përpjesëtim me përqindjen e Kuotave përkatëse që zotërojnë në kohën e Njoftimit të Shitjes. Nëse ndonjëri prej atyre që kanë të Drejtën e Parablerjes nuk e ushtron të Drejtën e Parablerjes, e Drejta e Parablerjes e dhënë për Anëtarët e tjerë rritet proporcionalisht, përveçse nëse ata kanë deklaruar se dëshirojnë të përdorin të Drejtën e Parablerjes vetëm dhe ekskluzivisht në përpjestim me Kuotat e tyre. Në çdo rast, Anëtari Shitës mund të vendosë të mos i shesë Kuotat e Ofruara tek Anëtarët e Ofruar; për pasojë, Anëtari Shitës do të ketë mundësinë të mos kryejë transaksionin me Anëtarët e Ofruar duke hequr dorë nga qëllimi i tij për të transferuar Kuotat, duke njoftuar Administratorët e Shoqërisë dhe Anëtarët e Ofruar, me letër të regjistruar me konfirmim marrje, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e Njoftimit të Pranimit.

Pa paragjykuar sa më sipër, mosdorëzimi i Njoftimit të Pranimit brenda Afatit të Parablerjes do të konsiderohet si refuzim i Anëtarit të Ofruar për të ushtruar të Drejtën e Parablerjes. Në rast se asnjë Anëtar i Ofruar nuk e ushtron të Drejtën e Parablerjes, atëherë Anëtari Shitës mund të shesë Kuotat e Ofruara tek Pala e Tretë Blerëse sipas kushteve dhe termave të përcaktuara në Njoftimin e Shitjes brenda dhe jo më vonë se 20 (njëzet) ditë pune pas përfundimit të Afatit të Parablerjes (për qëllimet e këtij paragrafi (c) "**Përfundimi i Afatit të Parablerjes**") dhe pa ndonjë detyrim të mëtejshëm ndaj Anëtarëve të Ofruar, me kusht që, menjëherë pas përfundimit të shitjes, Anëtari Shitës do t'u sigurojë Administratorëve dhe Anëtarëve të tjerë dëshmi me shkrim për përfundimin e shitjes. Nëse transferimi tek Pala e Tretë Blerëse nuk kryhet brenda Përfundimit të Afatit të Parablerjes, Anëtari Shitës nuk do



të lejohet të transferojë Kuotat e ofruara te Pala e Tretë Blerëse dhe procedura e së Drejtës së Parablerjes e përcaktuar në këtë paragraf (c) duhet të përsëritet. Nëse Kuotat transferohen në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në këtë paragraf (c) dhe të së Drejtës së Parablerjes të përshkruar në këtë dokument, atëherë transferimi te blerësi nuk do të ketë asnjë efekt, as ndaj Shoqërisë, dhe blerësi nuk do të ketë të drejtë të ushtrojë të drejtën e votës, dhe as ndonjë të drejtë tjetër administrative, pronësore dhe korporative që lidhet me Kuotat dhe statusin e tij si anëtar i Shoqërisë dhe, Administratorët nuk do të regjistrojnë blerësin përkatës në regjistrin e Shoqërisë.

Në rast se një ose më shumë Anëtarë të Ofruar ushtrojnë në kohë të Drejtën e Parablerjes, por çmimi i Kuotave të Ofruara konsiderohet i tepruar nga ndonjë prej Anëtarëve të Ofruar, të cilët kanë shprehur dëshirën e tyre për të ushtruar të Drejtën e Parablerjes në mënyrën dhe brenda afateve kohore të përcaktuara më sipër, ose në të gjitha rastet kur natyra e transferimit nuk parashikon kompensim ose kompensimi nuk është në para, çmimi i shitjes së Kuotave të Ofruara do të përcaktohet me marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet Anëtarëve të përfshirë brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga marrja e Njoftimit të Pranimit. Nëse nuk arrihet marrëveshje, çmimi do të përcaktohet me një deklaratë të vërtetuar vlerësimi nga një ekspert i tretë i caktuar nga Gjykata kompetente, me kërkesë të Anëtarit më të kujdesshëm; në bërjen e deklaratës së tij të vlerësimit, eksperti do të marrë në konsideratë pozicionin financiar të Shoqërisë si dhe vlerën e aktiveve materiale dhe jomateriale në pronësi të saj, pozicionin në treg dhe çdo rrethanë dhe kusht tjetër që zakonisht merret në konsideratë për qëllimin e përcaktimit të vlerës së Kuotave. Nëse çmimi i përcaktuar nga eksperti në deklaratën e tij është më i lartë se çmimi i ofruar nga Pala e Tretë Blerëse, transferimi te Anëtari/ët e Ofruar që ushtrojnë të Drejtën e Parablerjes do të bëhet me çmimin e ofruar nga Pala e Tretë Blerëse; pa paragjykuar të drejtën e Anëtarit Shitës për të mos vazhduar me transferimin tek Anëtari/ët Ofrues që kanë ushtruar të Drejtën e tyre të Parablerjes, dhe nëse çmimi i vendosur nga eksperti është më i ulët se çmimi i ofruar nga Pala e Tretë Blerëse, transferimi do të bëhet me çmimin e përcaktuar nga eksperti.

Pa paragjykuar sa më sipër, nëse Anëtari Shitës pranon të kryejë transaksionin me Anëtarët e Ofruar, atëherë transferimi i Kuotave të Ofruara do të ndodhë në një kohë dhe vend të arsyeshëm të pranueshëm për Anëtarët e përfshirë, sa më shpejt që të jetë e mundur, të kushtëzuar me pajtueshmërinë me çdo ligj ose rregullore të zbatueshme antitrust sipas Ligjit të Zbatueshëm. Në një transferim të tillë, Anëtarët e Ofruar do të paguajnë çmimin e rënë dakord për blerjen e Kuotave të Ofruara dhe Anëtari Shitës do t'i transferojë Kuotat e Ofruara të lira nga cdo Barrë (përveç Barrëve të krijuara në lidhje me borxhin e Shoqërisë) dhe të gjitha dokumentet dhe instrumentet e tjera të transferimit të kërkuara për të realizuar shitjen e Kuotave të Ofruara në përputhje me të njëjtat kushte dhe terma të shitjes të përcaktuara në Njoftimin e Shitjes. Përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe, të gjitha taksat, tarifrat ose tarifrat e ngjashme qeveritare në lidhje me transferimin e Kuotave të Ofruara (përveç taksave direkte që lidhen me

transferimin që do të paguhet nga Anëtarit Shitës) do të paguhet nga Anëtarët e Ofruar, të cilët do të paguajnë kostot dhe shpenzimet e tyre në lidhje me këtë shitje.

(d) Dalja. Me ndodhjen e një Ngjarjeje Shkaktuese, Anëtarit të cilit nuk i ka ndodhur kjo ngjarje do të ketë opsionin për të blerë ose shitur Kuotat e tij, pa paragjykuar të Drejtën e Parablerjes, të Drejtën e Bashkë-shitjes (Tag-Along) dhe të Drejtën e Detyrimit për Bashkë-shitje (Drag-Along) të përshkruara këtu.

(e) Regjistrimi në Regjistër. Transferimet e kuotave pasqyrohen në regjistrin e posaçëm të miratuar sipas nenit 2.2 (*Regjistri i Kuotave*) të këtij Statuti. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky Statut, mos pasqyrimi i transferimit të kuotave në këtë regjistër nuk e zhvleftëson aktin e transferimit.

(f) Transferimi i kuotave në rast vdekjeje të një Anëtarit. Në rast të vdekjes së një Anëtarit, Anëtarët e tjerë duhet të vendosin, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga vdekja, nëse do të:

- likuidojnë kuotat e trashëgimtarëve të Anëtarit të vdekur ("**Trashëgimtarët**"),
- vazhdojnë veprimtarinë e Shoqërisë me Trashëgimtarët (në këtë rast, Shoqëria mund të vazhdojë, edhe me një, disa ose të gjithë trashëgimtarët e të ndjerit, sipas marrëveshjes së ndarjes së trashëgimisë mes tyre),
- shpërbëjnë Shoqërinë.

Në rast të likuidimit të Kuotave të Trashëgimtarëve dhe/ose shpërbërjes së Shoqërisë, Trashëgimtarët kanë të drejtën e rimbursimit të Kuotave të Anëtarit të vdekur në përpjesëtim me aktivet e Shoqërisë; për këtë qëllim, kjo e fundit do të përcaktohet duke marrë parasysh vlerën e saj të drejtë të tregut në kohën e likuidimit/shpërbërjes, dhe veçanërisht duke marrë parasysh pozicionin financiar të Shoqërisë dhe perspektivat e të ardhurave të saj, si dhe vlerën e aktiveve materiale dhe jomateriale që zotëron, pozicionin e saj në treg dhe çdo rrethanë dhe kusht tjetër që zakonisht merret në konsideratë për qëllime të përcaktimit të vlerës së kapitalit të shoqërisë; në rast mosmarrëveshjeje, pala mund të caktojë Gjykatën kompetente për të përcaktuar vlerën e rimbursimit të Kuotave të Anëtarit të vdekur. Paga do t'u bëhet nga Shoqëria Trashëgimtarëve të Anëtarit të vdekur brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga vdekja. Vendimet në lidhje me vazhdimin e Shoqërisë me Trashëgimtarët, ose likuidimin e Kuotave për Trashëgimtarët e Anëtarit të vdekur mund të merren nga Asambleja në përputhje me nenin 3.02 shkronja (e) më poshtë, pa marrë parasysh, për qëllimet e llogaritjes së shumicës, Kuotat e Anëtarit të vdekur.

(g) E Drejta e Bashkë-Shitjes (Tag-Along). Për ushtrimin e së drejtës së bashkë-shitjes ("**E Drejta e Bashkë-Shitjes**"), do të zbatohet dispozita e mëposhtme e përcaktuar në këtë Paragraf (g). Pa paragjykuar të Drejtën e Parablerjes të përmendur në Paragrafin (c) më sipër, dhe të Drejtën e

Detyrimit për Bashkë-Shitje (Drag-Along) të përmendur në paragrafin (h) më poshtë, nëse Anëtar i 1 (për qëllime të këtij Paragrafi (g) **"Anëtari Shitës"**) synon të transferojë Kuotat tek një palë e tretë blerëse (për qëllimet e këtij paragrafi (g) **"Pala e Tretë Blerëse"**), Anëtari Shitës duhet të njoftojë me shkrim për një synim të tillë, të dërguar me letër të regjistruar me konfirmim marrje ose mjete të ngjashme që garanton provën e marrjes, dhe që do të përfshihet në Njoftimin e Shitjes të përshkruar në Paragrafin (c) më sipër (në tekstin e mëtejshëm, për qëllimet e këtij Paragrafi (g) **"Njoftimi i Transferimit"**, tek Anëtarët e Tjerë (për qëllime të këtij Paragrafi (g) **"Anëtarët e Tjerë"**) duke treguar (i) Kuotat që do t'i transferohen Palës së Tretë Blerëse (për qëllimet e këtij paragrafi (g) **"Kuotat që do të Transferohen"**), (ii) identitetin e Palës së Tretë Blerëse, (iii) çmimin e transferimit dhe (iv) termat dhe kushtet e pagesës. Anëtarëve të Tjerë do t'u jepet e drejta e Bashkë-Shitjes (Tag-Along), e cila do të ushtrohet, së bashku ose veçmas, në përputhje me procedurat dhe kushtet e përcaktuara në këtë Paragraf (g), dhe për rrjedhojë e drejta për të shitur Kuotat e tyre tek Pala e Tretë Blerëse, dhe Anëtari Shitës do të ketë detyrimin të sigurojë që Pala e Tretë Blerëse të blejë në të njëjtën kohë me Kuotat që do të Transferohen, edhe kuotat e Anëtarëve të Tjerë, në mënyrë proporcionale me Kuotat që do të Transferohen.

Kuotat e Anëtarëve të Tjerë që ushtrojnë të Drejtën e Bashkë-Shitjes (Tag-Along), do të transferohen me të njëjtin çmim për Kuotë dhe me të njëjtat kushte të zbatueshme për transferimin e Kuotave që do të Transferohen nga Anëtari Shitës tek Pala e Tretë Blerëse, me kusht që, nëse Anëtari Shitës i jep Palës së Tretë Blerëse përfaqësime, garanci dhe/ose detyrime kompensimi në favor të Palës së Tretë Blerëse, Anëtarët e Tjerë që ushtrojnë të Drejtën e Bashkë-Shitjes (Tag-Along), do të jenë të detyruar t'i japin Palës së Tretë Blerëse të njëjtat detyrime kompensimi por në mënyrë proporcionale, në përputhje me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

Anëtarët e Tjerë do të kenë të drejtë në mënyrë individuale, të ushtrojnë të Drejtën e Bashkë-Shitjes (Tag-Along), duke i dhënë një njoftim me shkrim Anëtarit Shitës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) Ditë Pune nga data e marrjes së Njoftimit të Transferimit (për qëllimet e këtij paragrafi (g) **"Afati i të Drejtës së Bashkë-Shitjes"**), duke iu nënshtruar dispozitave të këtij Paragrafi. Nëse Kuotat që do të Transferohen do t'i transferohen pa pagesë Palës së Tretë Blerëse, ose çmimi i ofruar nga Pala e Tretë Blerësi kundërshtohet, është i papërcaktuar për ndonjë arsye ose nuk përbëhet tërësisht ose pjesërisht nga vlera monetare, secili nga Anëtarët e Tjerë mund të kundërshtojnë vlerën që i atribuohet Kuotave që do të Transferohen, të parashikuar në Njoftimin përkatës të Transferimit, përmes një njoftimi me shkrim, dhe në këtë rast do të zbatohen dispozitat e Paragrafit (i) më poshtë.

Në rast se Anëtarët e Tjerë ushtrojnë të Drejtën e Bashkë-Shitjes (Tag-Along), transferimi i Kuotave të tyre tek Pala e Tretë Blerëse do të bëhet njëkohësisht dhe në të njëjtin vend me transferimin e Kuotave që do të Transferohen. Në rast se, për çfarëdo arsye, nuk realizohet transferimi i Kuotave që do të Transferohen, tek Pala e Tretë Blerëse, ushtrimi i së Drejtës së Bashkë-Shitjes (Tag-Along), nuk prodhon asnjë efekt ndaj Shoqërisë, dhe Administratorët nuk do të regjistrojnë blerësin në regjistrin e Shoqërisë, e për rrjedhojë blerësi



përkatës nuk do të mund të ushtrojë të drejta korporative në lidhje me statusin e tij si anëtar.

(h) E Drejta e Detyrimit për Bashkë-Shitje (Drag-Along). Për ushtrimin e së drejtës së detyrimit për bashkë-shitje ("**E Drejta e Detyrimit për Bashkë-Shitje**"), do të zbatohet dispozita e mëposhtme e përcaktuar në këtë paragraf (h). Pa paragjykuar të Drejtën e Parablerjes të përmendur në paragrafin (c) më sipër, nëse Anëtari 1 (për qëllimet e këtij paragrafi (h) "**Anëtari Shitës**") merr një ofertë nga një palë e tretë blerëse (për qëllime të këtij paragrafi (h) "**Pala e Tretë Blerëse**") për blerjen e të gjithë kapitalit të Shoqërisë, Anëtarit Shitës i jepet e Drejta e Detyrimit për Bashkë-Shitje dhe Anëtari Shitës do të ketë të drejtë t'i kërkojë Anëtarit 2 dhe Anëtarit 3 (për qëllimet e këtij Paragrafi (h) "**Anëtarët e Tjerë**"), me një njoftim me shkrim, i cili do të përfshihet në Njoftimin e Shitjes, të përshkruar sipas Paragrafit (c) më sipër (për qëllime të këtij paragrafi (c) "Njoftimi i Detyrimit për Bashkë-Shitje"), që do të dërgohet me postë të regjistruar me konfirmim marrje ose mjet të ngjashëm që garanton provën e marrjes, drejtuar Anëtarëve të Tjerë, të cilët, pa paragjykuar të Drejtën e tyre të Parablerjes sipas Paragrafit (c), do të jenë të detyruar t'i transferojnë të gjitha (dhe jo më pak se të gjitha) Kuotat e tyre tek Pala e Tretë Blerëse në të njëjtat kushte dhe terma që zbatohen nga Anëtari Shitës për kuotat e tij me Palën e Tretë Blerëse. Njoftimi i Detyrimit për Bashkë-Shitje duhet të tregojë (i) emrin dhe identitetin e Palës së Tretë Blerëse dhe (ii) termat dhe kushtet e transferimit të ofruara dhe, në veçanti, çmimin për Kuotë të ofruar nga Pala e Tretë Blerëse dhe kushtet e pagesës. Në rast se e Drejta e Parablerjes nuk ekzekutohet në përputhje me Paragrafin (c) dhe në rast të ushtrimit të së Drejtës së Detyrimit për Bashkë-Shitje (Drag-Along), transferimi i Kuotave do të bëhet me çmimin dhe termat dhe kushtet e treguara në Njoftimin e Detyrimit për Bashkë-Shitje gjatë rrjedhës së ekzekutimit të këtij transferimi të Kuotave, i cili duhet të bëhet në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

- transferimi duhet të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme (me kusht që të jenë marrë të gjitha autorizimet, pëlqimet ose lejet e kërkuara nga ligjet dhe rregulloret në fuqi), duke rënë dakord që data e transferimit duhet t'i njoftohet secilit Anëtar Tjetër me të paktën 40 (dyzet) Ditë Pune njoftim paraprak;
- Anëtari Shitës dhe Anëtarët e Tjerë duhet (i) të kenë titull të plotë dhe të transferueshëm mbi Kuotat që Transferohen, të cilat duhet të jenë të lira nga çdo Barrë dhe duhet të kenë të drejta dhe kompetenca të plota dhe të gjitha autorizimet e këshillueshme për të shitur, caktuar, transferuar dhe atribuar këto Kuota; (ii) t'i lëshojnë Palës së Tretë Blerëse të njëjtat përfaqësime dhe garanci; dhe (iii) të marrin përsipër në favor të Palës së Tretë Blerëse të njëjtat detyrime kompensimi në mënyrë proporcionale në përputhje me kuotat e tyre në Shoqëri;
- Anëtari Shitës, Anëtarët e Tjerë dhe Pala e Tretë Blerëse duhet të lidhin dhe shkëmbejnë të gjitha aktet që mund të jenë të nevojshme në përputhje me dispozitat e Ligjit të Zbatueshëm në mënyrë që t'i transferojnë Palës së Tretë Blerëse titullin e plotë dhe të transferueshëm të këtyre Kuotave;



- Pala e Tretë Blerëse duhet të paguajë çmimin e ofruar dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet që lidhen me një transferim të tillë, duke përfshirë tarifat noteriale.

Nëse çmimi i blerjes i ofruar nga Pala e Tretë Blerëse për transferimin e Kuotave që do të Transferohen, kundërshtohet, është i papërcaktuar për ndonjë arsye ose nuk përbëhet tërësisht ose pjesërisht nga vlera monetare, do të zbatohet dispozita e Paragrafit (i) më poshtë. Transferimi i Kuotave tek Pala e Tretë Blerëse i realizuar në kundërshtim me dispozitat e këtij Paragrafi (h) duhet të konsiderohet i pazbatueshëm ndaj Shoqërisë dhe Anëtarëve të Tjerë dhe, për rrjedhojë, Administratorët nuk do të regjistrojnë blerësin në regjistrin e Shoqërisë, e për rrjedhojë blerësi përkatës nuk do të mund të ushtrojë të drejta korporative në lidhje me statusin e tij si anëtar.

(i) Në përputhje me Paragrafin (c), (g) dhe (h) më sipër, në rast se Anëtari Shitës dëshiron të transferojë Kuotën e tij tek Pala e Tretë Blerëse (sipas rastit) nëpërmjet një akti gjatë jetës ("inter vivos") pa kundërshtpërblim dhe/ose me një vlerë simbolike, ose me një vlerë të papërcaktuar për çfarëdo arsye ose pa kundërvlerë monetare (si, për shembull, por pa u kufizuar vetëm në, kontribut, shkëmbim, dhurim, zgjidhje me pajtim etj.), ai duhet ta specifikojë këtë në njoftimin përkatës (pra, në Njoftimin e Shitjes sipas Paragrafit (c), Njoftimin e Transferimit sipas Paragrafit (g) dhe Njoftimin e Detyrimit për Bashkë-Shitje sipas Paragrafit (h)) duke treguar gjithashtu vlerën në para që i atribuon Kuotës së përmendur në njoftimin përkatës.

Në një rast të tillë, secili nga Anëtarët e Tjerë mund të kundërshtojë vlerën e atribuar nga Anëtari Shitës ndaj Kuotës të përmendur në njoftimin përkatës, duke dërguar një njoftim me shkrim (në tekstin e mëtejshëm "**Njoftimi i Mospajtimit**") brenda Afatit të së Drejtës së Bashkë-Shitjes.

Secili nga Anëtarët e Tjerë, sipas rastit, ka të drejtë të kërkojë, brenda afatit të parashikuar më sipër, që vlera e drejtë e tregut të Kuotave që do të transferohen të caktohet në mënyrë që të përcaktohet çmimi përkatës për ushtrimin e të drejtave të parashikuara në Paragrafin (c), (g) dhe (h) më sipër.

Në një rast të tillë, Anëtari Shitës së bashku me Anëtarët e Tjerë që kanë dërguar Njoftimin e Mospajtimit, do të negociojnë në mirëbesim, për një periudhë prej 10 (dhjetë) ditësh nga data e marrjes së Njoftimit të Mospajtimit, për të arritur një marrëveshje për çmimin e blerjes së Kuotës së përmendur në njoftimin përkatës. Në rast se nuk arrihet marrëveshje, Anëtari Shitës së bashku me Anëtarët e Tjerë që kanë njoftuar Njoftimin e Mospajtimit do të caktojnë një ekspert brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës së lartpërmendur dhe eksperti detyrohet të japë përcaktimin e vlerës së drejtë të tregut brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga emërimi i tij.

Mandati për ekspertin do të jepet nga Anëtari Shitës së bashku me Anëtarët e Tjerë që kanë dërguar Njoftimin e Mospajtimit, të cilët do të ndajnë shpenzimet për shërbimet e ekspertit në përputhje me Koutat e tyre në Shoqëri, duke u kujdesur të specifikojnë se ky mandat do të konsiderohet, për të gjitha efektet ligjore, si një mandat i përbashkët i dhënë nga Anëtari Shitës dhe Anëtarët e Tjerë të përfshirë. Gjithashtu, është rënë dakord se, në

rast të mosdhënies së mandatit nga Anëtari Shitës dhe Anëtarët e Tjerë, mandati mund të jepet individualisht nga pala më e kujdesshme.

Ekspteri: (i) nuk ka të drejtë të marrë vendime mbi bazë të barazisë, përveç në masën që është rreptësisht e nevojshme për zgjidhjen e çështjeve të paparashikuara nga ky Statut; (ii) do të marrë parasysh vërejtjet, komentet dhe kundërshtimet e Anëtarit Shitës dhe të Anëtarëve të Tjerë që dërguan Njoftimin e Mospajtit në masën që ai e gjykon të arsyeshme, duke dhënë një shpjegim të qartë të arsyeve që qëndrojnë në themel të pranimi ose refuzimit të të njëjtit; (iii) brenda 30 ditëve nga pranimi i mandatit, do të marrë vendimin e tij, duke i dërguar Anëtarit Transferues dhe Anëtarëve të Tjerë që dërguan Njoftimin e Mospajtit, sipas rastit, një raport që ilustron dhe justifikon përcaktimin e vlerës së drejtë të tregut.

Për qëllim të këtij paragrafi (i), vlera aktuale në para e Kuotës për ushtrimin e të drejtave të parashikuara në paragrafin (c), (g) dhe (h) më sipër: (i) njoftohet në lidhje me të cilën nuk është dërguar një Njoftim Mospajtimi; ose (ii) e vendosur në marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet Anëtarit Shitës dhe Anëtarëve të Tjerë; ose, (iii) e përcaktuar nga ekspertit në përputhje me këtë Paragraf (i), do të jetë përfundimtare dhe e detyrueshme për Anëtarin Transferues dhe për Anëtarët e Tjerë.

Anëtarët e tjerë që dërguan Njoftimin e Mospajtit të përcaktuar në këtë Paragraf (i) mund të ushtrojnë të drejtat përkatëse të parashikuara në Paragrafët (c), (g) dhe (h) sipas rastit, duke dërguar njoftimin përkatës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data në të cilën vlera në para e Kuotës është bërë përfundimtare në përputhje me këtë Paragraf (i).

Transferimi i Kuotës tek Pala e Tretë Blerëse e kryer në kundërshtim me dispozitat e këtij paragrafi (i) duhet të konsiderohet i pazbatueshëm kundër Shoqërisë dhe Anëtarëve të Tjerë dhe, për rrjedhojë, Administratorët nuk do të regjistrojnë blerësin në regjistrin e Shoqërisë, e për rrjedhojë blerësi përkatës nuk do të mund të ushtrojë të drejta korporative në lidhje me statusin e tij si anëtar.

Neni 2.04 Rritja dhe Zvogëlimi i Kapitalit

(a) Rritja e Kapitalit. Asambleja vendos për rritjen e kapitalit të regjistruar nëpërmjet kontributeve në para dhe/ose në natyrë. Rritja e kapitalit mund të realizohet nga Anëtarët ekzistues ose nga një person i tretë, i cili, përmes kontributit të tij në kapitalin e Shoqërisë, bëhet Anëtar në përpjesëtim me vlerën e kontributit të tij. Për të shmangur çdo paqartësi, futja e një personi të tretë si Anëtar i Shoqërisë nëpërmjet rritjes së kapitalit kryhet me vendim të Asamblesë në përputhje me nenin 3.02 (e). Në rast vendimi për rritjen e kapitalit nëpërmjet kontributeve të reja, Anëtarët kanë të drejtë të nënshkruajnë kapitalin në përpjesëtim me Kuotat që zotërojnë (në tekstin e mëtejshëm **"Të Drejtat e Opsionit"**). Vendimi për rritjen e kapitalit duhet të tregojë afatin e ushtrimit të së Drejtës së Opsionit, i cili në asnjë rast nuk mund të jetë më pak se 30 (tridhjetë) ditë nga data në të cilën Anëtarët njoftohen se rritja mund të nënshkruhet. Administratorët duhet të dërgojnë bashkërisht njoftimin për të gjithë Anëtarët me postë të regjistruar me konfirmim marrje (ose mjet tjetër të ngjashëm); për qëllimet e këtij Paragrafi, konsiderohen Anëtarë ata që rezultojnë në Regjistrin e Shoqërisë ose që mund të provojnë anëtarësimin e tyre duke treguar një titull blerjeje të paraqitur siç duhet në Regjistrin e Shoqërisë; ky njoftim mund të evitohet nëse të gjithë Anëtarët deklarojnë, në të njëjtën kohë me marrjen e vendimit për rritjen e kapitalit, se janë të informuar për ofertën e opsionit dhe afatin përkatës; në këtë rast, afati për ushtrimin e së Drejtës së Opsionit fillon nga data e regjistrimit të vendimit për rritje kapitali. Anëtarët që ushtrojnë të Drejtën e Opsionit, nëse bëjnë një kërkesë të njëkohshme, kanë të drejtën e parablerjes për nënshkrimin e çdo kuote që nuk i është nënshtruar opsionit; nëse rritja e kapitalit nuk nënshkruhet në tërësi nga Anëtarët, pjesa e panënshkruar mund të vendoset për nënshkrim tek palët e treta, përveç rasteve kur vendimi për rritjen e kapitalit e përjashton këtë mundësi. Anëtarët kanë të drejtë të deklarojnë shprehimisht në vendimin për rritjen e kapitalit se rritja mund të zbatohet gjithashtu duke ofruar të gjitha ose një pjesë të kuotave të reja palëve të treta; në këtë rast, ashtu si në rastin e një vendimi për rritjen e kapitalit që do të paguhet me kontribut në natyrë, dhe nëse plotësohen kushtet ligjore, me pasojë përjashtimin ose kufizimin e të Drejtës së Opsionit, u jepet e drejta e tërheqjes Anëtarëve që nuk kanë dhënë miratimin për vendimin.

(b) Zvogëlimi i kapitalit miratohet me vendim të Asamblesë në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm. Në çdo rast, kapitali i Shoqërisë nuk mund të jetë më i ulët se minimumi ligjor.

KREU III. STRUKTURA E SHOQËRISË

Neni 3.01 Organet Drejtuese

(a) Organet drejtuese dhe administruese të Shoqërisë janë:

- (1) Asambleja; dhe
- (2) Administratori/ët.

Neni 3.02 Asambleja – Mbledhja e Anëtarëve

(a) Asambleja mund të thirret nga një ose më shumë Administratorë, ose çdo Anëtar që zotëron të paktën 5 (pesë) për qind të totalit të kapitalit, në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Mbledhja mund të zhvillohet fizikisht në zyrat e Shoqërisë, virtualisht, me telefon, konferencë telefonike apo në çdo formë tjetër të specifikuar nga Anëtarët në këtë Statut.

(b) Të gjitha njoftimet për thirrjen e Asamblesë do të bëhen sipas dispozitave të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, me letër të regjistruar, me faks ose e-mail. Ky njoftim do të përmbajë kohën, vendin, rendin e ditës, vendimet e propozuara me materialet shoqëruese, kushtet për pjesëmarrje në mbledhje si dhe çdo kërkesë tjetër të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

(c) Asambleja do të caktojë një kryetar, i cili do të përgatisë rendin e ditës për çdo mbledhje (duke përfshirë çështjet e paraqitura nga Administratori dhe/ose Anëtarët) dhe do të udhëheqë mbledhjen ("**Kryetari**").

(d) Pjesëmarrja e Anëtarëve. Anëtarët mund të marrin pjesë personalisht në Mbledhje ose të përfaqësohen me prokurë me shkrim, në përputhje me kufizimet e parashikuara nga Ligji i Zbatueshëm. Përfaqësimi duhet të jepet në formë të shkruar dhe dokumentet përkatëse duhet të ruhen nga Shoqëria.

(e) Vendimmarrja e Asamblesë. Asambleja mblidhet në mënyrë të vlefshme kur në mbledhje marrin pjesë Anëtarë që përfaqësojnë shumicën e kapitalit (d.m.th. me praninë e 50% + 1 të kapitalit të Shoqërisë), dhe vendimet merren me votat pozitive të Anëtarëve që përfaqësojnë shumicën e kapitalit (për të shmangur çdo paqartësi, Asambleja merr vendime me votën pozitive të më shumë se 50% + 1 të kapitalit të Shoqërisë).

(f) Procesverbali i Mbledhjes. Kryetari i Asamblesë do të sigurojë që të mbahet procesverbali i mbledhjes së Asamblesë. Procesverbali duhet të përmbajë të paktën emrin e regjistruar të Shoqërisë, vendin dhe orën, emrin e Kryetarit të Mbledhjes dhe të personit që mban procesverbalin, një përshkrim të shkurtër të secilës pikë të rendit të ditës, rezultatin e votimit për secilën pikë të rendit të ditës, numrin e votave për vendimin/e) dhe listën e Anëtarëve pjesëmarrës.

(g) Procesverbali nënshkruhet nga Kryetari i mbledhjes dhe mbajtësi i procesverbalit (i cili emërohet në fillim të mbledhjes nga Asambleja me vendimin e marrë nga shumica e Anëtarëve) dhe u dërgohet Anëtarëve brenda një afati të arsyeshëm pas mbledhjes me postë, e-mail, ose çdo metodë tjetër të miratuar nga Asambleja.

(h) Regjistrimi i Vendimeve. Të gjitha vendimet e Asamblesë regjistrohen në një regjistër të veçantë.



Neni 3.03 Kompetencat e Asamblesë

- (a) Asambleja do të jetë autoriteti më i lartë i Shoqërisë.
- (b) Asambleja ka këto kompetenca të rezervuara:
- (1) Miratimi i ndryshimeve të Statutit ose ndryshimeve në objektin e veprimtarisë së Shoqërisë;
 - (2) Miratimi ose ndryshimi i planit të biznesit dhe/ose buxhetit vjetor të Shoqërisë;
 - (3) Miratimi i rritjes së kapitalit dhe/ose emetimit të Kuotave të reja në Shoqëri (përfshirë opsionet, garancitë dhe të drejta të tjera për të nënshkruar letra me vlerë të Shoqërisë), qoftë në formë kapitali, huaje apo instrumentesh hibride;
 - (4) Emërimi dhe shkarkimi i Administratorit/ëve dhe caktimi i shpërblimit të tyre;
 - (5) Emërimi dhe shkarkimi i ekspertit/ëve kontabël si dhe i likuidatorit/ëve (kur kërkohet nga Ligji i Zbatueshëm), dhe caktimi i shpërblimit të tyre;
 - (6) Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - (7) Shpërndarja e dividendëve;
 - (8) Ndryshimi i kapitalit të regjistruar ose i adresës së regjistruar të Shoqërisë, si dhe hapja e degëve ose zyrave të reja të Shoqërisë;
 - (9) Vendimmarrja mbi bashkime, ndarje, pjesëtim, veçim, shitje, blerje ose riorganizime të Shoqërisë, ose shitjen, likuidimin apo blerjen (qoftë në një transaksion të vetëm ose në një seri transaksionesh të lidhura) të çdo pasurie apo aktiviteti tregtar
 - (10) Vendimmarrja mbi hyrjen në sipërmarrje të përbashkëta (joint ventures) ose partneritete të çdo lloji, përfshirë partneritete të heshtura, apo çdo marrëveshje që i jep palës tjetër të drejtën për pjesëmarrje në fitimin e Shoqërisë ose të drejtën për shpërblim të kushtëzuar nga niveli i fitimit të Shoqërisë;
 - (11) Vendimmarrja mbi likuidimin ose shpërbërjen e Shoqërisë;
 - (12) Ndryshimi i strukturës organizative të Shoqërisë;
 - (13) Përcaktimi ose ndryshimi i planeve për ndarjen e fitimit, bonuseve ose stimujve të tjerë për punonjësit e Shoqërisë;
 - (14) Marrja e huave ose marrëveshjeve të qirasë financiare, ku Shoqëria ka cilësinë e huamarrësit;
 - (15) Miratimi i borxheve, qoftë afatshkurtra apo afatgjata, si dhe çdo borxhi të çdo forme apo mënyre, që tejkalon shumën prej 1.483.200,00 lekësh (ekuivalent me EUR 15,000), qoftë në formë huaje afatshkurtër ose afatmesme/afatgjatë;
 - (16) Dhënia e garancive, sigurimeve ose kompensimeve për përmbushjen e detyrimeve ose për marrjen përsipër të angazhimeve të palëve të treta;
 - (17) Vendimmarrja mbi miratimin e të gjitha veprimeve ose pagesave që tej kalojnë vlerën prej 1.483.200,00 lekësh (ekuivalent me EUR 15,000) dhe/ose të gjitha angazhimeve kontraktuale mbi bazën e të cilave Shoqëria pritet të përfitojë ose të kryejë pagesa,



përfitime apo shërbime në një vlerë më të madhe se 1.483.200,00 lekë (ekuivalent me EUR 15,000) gjatë kohëzgjatjes së kontratës përkatëse;

- (18) Vendimmarrja mbi miratimin dhe dhënien e autorizimit paraprak për Administratorit/ëve në lidhje me **Çështjet e rezervuara** (siç përkufizohen më poshtë).

(c) Kompetenca të tjera. Asambleja, përveç asaj që parashikohet në paragrafin (b) të këtij neni, ushtron çdo kompetencë tjetër të parashikuar nga Ligji i Zbatueshëm ose nga ky Statut.

(d) Asambleja ushtron të gjitha të drejtat dhe përmbush të gjitha detyrimet në përputhje me këtë Statut dhe Ligjin e Zbatueshëm. Asambleja merr vendimet e nevojshme për Shoqërinë dhe autorizon Administratorin ose çdo person tjetër, sipas rastit, për të nënshkruar, zbatuar dhe ekzekutuar vendimet e Asamblesë.

Neni 3.04 Emërimi i Administratorit/ëve

(a) Emërimi i Administratorit. Asambleja zgjedh një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të Shoqërisë për një periudhë maksimale pesë vjeçare, në përputhje me përcaktimet e shkronjës "c" të pikës 1 të Nenit 81 dhe Nenit 95 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Emërimet do të bëhen me vendim të miratuar nga Asambleja në përputhje me paragrafin 3.02 shkronja (e).

(b) Kufizimet. Kufizimet në lidhje me emërimin e Administratorëve parashikohen në pikën 2 të Nenit 95 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Administratorët mund të jenë gjithashtu jo Anëtarë të Shoqërisë.

(c) Administratori i Shoqërisë. Pas themelimit të Shoqërisë, Anëtarët bien dakord dhe vendosin që Administratori i Shoqërisë të jetë:

- (1) Znj. Evelina Merkaj, shtetase shqiptare, e datëlindjes 8 korrik 1996, mbajtëse e pasaportës shqiptare me nr. Personal J65708095F,

e cila do të qëndrojë në krye për periudhën 5 (pesë) vjeçare nga themelimi i Shoqërisë.

(d) Administratorja Evelina Merkaj është e ngarkuar dhe e autorizuar të ushtrojë kompetencat e mëposhtme, të kufizuara vetëm në kuadrin e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, për qëllime të zhvillimit të aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë, brenda kufijve të shpenzimeve të specifikuara më poshtë:

- 1) Të kryejë menaxhimin e aktivitetit tregtar të Shoqërisë, nëpërmjet zbatimit të planit të biznesit dhe/ose buxhetit vjetor të miratuar nga Asambleja;

- 2) Të përfaqësojë Shoqërinë përballë palëve të treta, përfshirë autoritetet publike dhe lokale, zyrat qeveritare, dhomat e tregtisë, agjencitë tatimore, institucionet e sigurimeve shoqërore, dhe sindikatat;
- 3) Të mbajë dhe ruajë në mënyrë të saktë dhe të rregullt dokumentacionin dhe librat kontabël të Shoqërisë;
- 4) Të hartojë, përgatisë dhe nënshkruajë projektin e bilancit vjetor dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilat do t'i paraqiten për miratim Asamblesë, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve të akumuluar;
- 5) Të mbikëqyrë aktivitetet e kryera nga Shoqëria sipas objektit të saj;
- 6) Të kryejë regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, sipas dispozitave të Ligjit të Zbatueshëm ose të Statutit;
- 7) Të raportojë përpara Asamblesë mbi zbatimin e politikave tregtare, projekteve dhe planit të biznesit dhe/ose buxhetit vjetor të miratuar nga Asambleja;
- 8) Të zbatojë urdhrat dhe vendimet e Asamblesë;
- 9) T'i vërë në dispozicion Anëtarëve të Shoqërisë çdo informacion mbi veprimtarinë e përditshme të Shoqërisë, përfshirë informacion të plotë mbi rezultatet financiare, që kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga ndonjë prej Anëtarëve;
- 10) Të punësojë, pezullojë dhe shkarkojë punonjës, bashkëpunëtorë (përfshirë me kontratë me bazë projekti), konsulentë dhe profesionistë të tjerë që Shoqëria mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për zbatimin e duhur të planit të biznesit të miratuar nga Asambleja – me përjashtim të drejtorëve dhe funksionarëve ekzekutivë.
- 11) Të negociojë, lidhë, nënshkruajë, ndryshojë dhe ndërpresë kontrata/marrëveshje tregtare me palë të treta, me qëllim zbatimin e objektit të Shoqërisë dhe të planit të saj të biznesit dhe/ose buxhetit vjetor të miratuar nga Asambleja, e kufizuar për ato veprime që përfshijnë një angazhim financiar për Shoqërinë që nuk e kalon vlerën maksimale prej 1.483.200,00 lekësh (ekuivalent me EUR 15,000) për secilin veprim të vetëm;
- 12) Të blejë dhe shesë mallra (me përjashtim të pasurive të paluajtshme), deri në shumën maksimale bruto prej 1.483.200,00 lekësh (ekuivalent me EUR 15,000);
- 13) Të krijojë detyrime financiare për Shoqërinë dhe/ose të marrë borxhe, qoftë afatshkurtra apo afatgjata, deri në shumën prej 1.483.200,00 lekësh (ekuivalent me EUR 15,000) për secilin veprim të vetëm; Administratori nuk mund të lidhë ndonjë kontratë/marrëveshje tjetër që nuk hyn në këto parametra, përveç nëse është shprehimisht e miratuar nga Asambleja;
- 14) Të hapë dhe mbyllë llogari bankare në çdo bankë apo institucion krediti në Shqipëri dhe jashtë saj; të kryejë pagesa, depozitime dhe tërheqje nga llogaritë bankare të Shoqërisë, deri në shumën maksimale prej 1.483.200,00 lekësh (ekuivalent me EUR 15,000), ose në çdo rast, brenda kufirit të linjave kreditore të miratuara për Shoqërinë (nëse janë

më të ulëta). Brenda këtyre kufijve, të lëshojë ose të transferojë çeqe bankare dhe të kërkojë urdhra pagese (bank drafts);

- 15) Të zgjidhë mosmarrëveshje ligjore, në rrugë gjyqësore ose jashtëgjyqësore, si dhe mosmarrëveshje tatimore, me përjashtim të marrëveshjeve të pajtimit që përfshijnë një angazhim pagese për Shoqërinë që tejkalon shumën prej 1.483.200,00 lekësh.

Kuptohet që kufiri i shpenzimeve i përcaktuar më sipër i referohet vlerës totale të kontratës apo transaksionit individual, pavarësisht nëse ky i fundit ndahet në disa veprime ose pagesa me vlera më të vogla; për rrjedhojë, Administratori nuk është i autorizuar të kryejë veprime që, ndonëse individualisht janë nën kufirin e shpenzimeve, përbëjnë pjesë të një operacioni të vetëm ekonomik ose kontraktual, vlera totale e të cilit e tejkalon këtë kufi.

Pa paragjykuar sa më sipër, kompetencat e administrimit të zakonshëm që tejkalojnë kufirin përkatës të shpenzimeve të përcaktuar më sipër, si dhe çdo akt i administrimit të jashtëzakonshëm, që nënkupton të gjitha veprimet që shkojnë përtej administrimit normal të përditshëm të Shoqërisë, përfshirë por pa u kufizuar vetëm në blerjen/shitjen e pasurive të paluajtshme dhe/ose pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera, nënshkrimin e kontratave të qirasë afatgjata, dhënien e huave të çdo lloji, dhënien e garancive në favor të palëve të treta, kryerjen e veprimeve bankare të jashtëzakonshme, që nuk kanë të bëjnë me administrimin e zakonshëm të Shoqërisë (të referuara së bashku si **“Çështjet e Rezervuara”**), rezervohen për Asamblenë, e cila duhet të miratojë paraprakisht dhe të autorizojë kryerjen e tyre nga Administratori, në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë Statut (shih Nenin 3.03, shkronja (b), nënparagrafi (18) më sipër).

Përveç rasteve kur Asambleja vendos ndryshe, Administratorja Evelina Merkaj nuk i nënshtrohet ndonjë detyrimi për ndalim konkurrence ndaj Shoqërisë, përfshirë kufizimet për konkurrencë të parashikuara në Nenin 17, paragrafi 1, të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 3.05 Kompetencat e Administratorit/ëve

(a) Politikat tregtare të Shoqërisë, të miratuara nga Asambleja, do të zbatohen nga Administratori/ët, të cilët mund të ushtrojnë kompetencat e dhëna Administratorit/ëve sipas Nenit 95 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, të cilat nuk janë rezervuar për Asamblenë e Përgjithshme sipas Nenit 81 të Ligjit, dhe sipas Nenit 3.03, shkronja (b), si dhe çdo kufizim tjetër të parashikuar në këtë Statut. Ndryshimet e Statutit nga Asambleja dhe udhëzimet e saj nuk do të shfuqizojnë aktet e mëparshme të Administratorit/ëve, të cilat do të kishin mbetur të vlefshme po të mos ishte bërë ndryshimi ose të mos ishte nxjerrë udhëzimi. Përveç rasteve kur Asambleja vendos ndryshe, çdo Administrator ka, veçmas, kompetencat për të përfaqësuar Shoqërinë përballë palëve të treta, si në marrëdhëniet me palët e treta ashtu edhe në proceset ligjore.

Neni 3.06 Kompensimi dhe përfitime të tjera



(a) Administratori do të kompensohet sipas skemës së përcaktuar nga Asambleja, në përputhje me dispozitat e Nenit 97 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

(b) Asambleja mund të miratojë përfitime, përfshirë kompensime monetare, pensione, sigurime apo forma të tjera, për çdo person që ka shërbyer por nuk është më në detyrë apo i punësuar në Shoqëri, në shoqëri të tjera që janë ose kanë qenë të kontrolluara prej saj, në paraardhëse të Shoqërisë aktuale ose në degë të saj; po ashtu, për çdo anëtar të familjes së tyre (përfshirë bashkëshortë, ish-bashkëshortë) ose persona që varen prej tyre.

Neni 3.07 Audituesi Ligjor

Për emërimin, përfundimin dhe funksionet e Audituesi Ligjor, do të zbatohen dispozitat ligjore përkatëse të përcaktuara me Ligjin e Zbatueshëm.

Neni 3.08 Hetimet speciale

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin apo zëvendësimin e një eksperti të fushës sipas Nenit 91 të Ligjit paraqesin një kërkesë të tillë nëpërmjet depozitimit të një deklarate noteriale në selinë e Shoqërisë e cila vërteton se personi ose personat plotësojnë kushtet për kryerjen e këtij veprimi.

KREU IV. VITI FINANCIAR DHE DIVIDENDI

Neni 4.01 Viti financiar

Çdo vit financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

Neni 4.02 Dividenti

(a) Shpërndarja e Dividendit. Asambleja mund të vendosë për shpërndarjen e dividendit dhe për përcaktimin e mënyrës së alokimit të fitimit që rezulton nga bilanci, pasi të jenë përmbushur kërkesat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare mbi shpërndarjen e fitimeve.

(b) Deklarimi i Dividendit. Dividenti deklarohet dhe paguhet në përpjesëtim me vlerën e kapitalit të regjistruar që përfaqëson kuotën për të cilin paguhet dividendi.

(c) Rezervat. Asambleja mund të vendosë për krijimin e rezervave nga fitimi vjetore.

Neni 4.03 Librat e Shoqërisë dhe Pajtueshmëria

(a) Librat dhe Dokumentet e Shoqërisë. Shoqëria do të mbajë libra dhe regjistrime të duhura në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm në lidhje me veprimtarinë e saj tregtare. Librat dhe dokumentet e Shoqërisë do të mbahen gjithmonë në selinë e regjistruar të Shoqërisë.

(b) Pajtueshmëria. Shoqëria do të bëjë përpjekjet e saj më të mira për të siguruar, dhe mbajtur në fuqi dhe për të zbatuar të gjitha miratimet, pëlqimet ose licencat e nevojshme për zhvillimin dhe përmbushjen e objektit të veprimtarisë së saj.

KREU V. TË NDRYSHME

Neni 5.01 Veçueshmëria

Termat, kushtet dhe dispozitat e këtij Statuti janë plotësisht të veçueshme, dhe çdo vendim apo gjykim i marrë nga një gjykatë kompetente që shpall të pavlefshme ose të pazbatueshme një ose më shumë prej këtyre termave, kushteve apo dispozitave, nuk do të ndikojë në vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e pjesës tjetër të Statutit. Çdo term apo dispozitë që shpallet e pavlefshme ose e pazbatueshme do të zëvendësohet me një dispozitë të vlefshme dhe të zbatueshme, e cila reflekton sa më afër të jetë e mundur qëllimin fillestar të Anëtarëve.

Neni 5.02 Shpërbërja dhe Likuidimi

Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe me vendim të Asamblesë, mund të shpërndajë të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë në dobi të Anëtarëve dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes, në përputhje me, dhe brenda kufijve të përcaktuar me Ligjin e Zbatueshëm.

Neni 5.03 Njoftimet

(a) Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Statut, të gjitha njoftimet që jepen nga çdo person në përputhje me dispozitat e këtij Statuti, duhet të jenë me shkrim ose të dërgohen përmes komunikimit elektronik në adresat e përcaktuara më poshtë. Njoftimet do të konsiderohen të vlefshme si për sa i përket kohës së dërgimit ashtu edhe personit njoftues, për sa kohë që ato janë dërguar në përputhje me mënyrat dhe adresat e përcaktuara për këtë qëllim.

(b) Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Statut, Shoqëria mund t'i dërgojë njoftime një Anëtarë nëpërmjet njërës prej metodave të mëposhtme: (i) me dorëzim fizik, (ii) me postë të regjistruar ose korrier me konfirmimin e marrjes, në adresën e regjistruar të Anëtarit në Shoqëri, ose (iii) me postë elektronike (email) në adresën e specifikuar më poshtë ose komunikuar më pas nga Anëtarë tek Shoqëria për qëllime njoftimi.

(c) Nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi nga disa persona, njoftimet i dërgohen përfaqësuesit të tyre të përbashkët të caktuar në përputhje me pikën 2 të Nenit 72 të Ligjit.

(d) Anëtarët do të njoftohen në adresat e mëposhtme:

- (1) Për Anëtarin Clink srl, njoftimet do t'i dërgohen në Largo Parolini 6 36061 Bassano del Grappa, Vi Italia;
- (2) Për Anëtarin Vincenzo Scolavino, njoftimet do t'i dërgohen në Rr. Robert Schwarz, Kompleksi Niku, Sh.1 Kati 7 ap.4 Italia.
- (3) Për Anëtarin Evelina Merkaj, njoftimet do t'i dërgohen në Rr. Robert Schwarz, Kompleksi Niku, Sh.1 Kati 7 ap.4 Tirana.

Neni 5.04 Ligji i Zbatueshëm

Ky Statut në të gjitha aspektet do të qeveriset dhe interpretohet në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm. Për aq sa nuk parashikohet në këtë Statut, zbatohen dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare, të Kodit Civil Shqiptar, si dhe të çdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

ANËTARËT

Clink Srl

PERFAQËSUAR NGA: Z. Stefano Falcone

[nënshkrimi]



Clink srl
Largo Parolini 6
36061 Bassano del Grappa, VI
P.IVA: 04337050241
COD.SDI: J6URRTW

Z. Vincenzo Scolavino

[nënshkrimi]



Znj. Evelina Merkaj

[nënshkrimi]

